



Prishtinë, 10.07.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3287_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2733_06_25** i datës 26.06.2026;
- Ankesa e konsumatorit e dt. 18.06.2026.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **I. A.**, nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2733_06_25 i datës 26.06.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me datë 26.06.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2733_06_25 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit I. A., me shifër DPR - 90082205, lidhur me kontestimin e faturës së muajin 01/2025, nën dyshimet për pasaktësi të matjes me njehsorin elektrik me nr. 63610878.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Unë nuk e kam krijuar gjithë shpenzimin e energjisë elektrike që më është faturuar;
- Shpenzimet në muajt e tjerë kanë qenë më të ulëta;
- Kërkojë që të rishqyrtohet fatura e kontestuar dhe të korrigjohet.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2026 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e konsumatorit të dt. 18.06.2026; Vendimin e DMK-së të dt. 26.06.2025, Ankesën e konsumatorit në DMK e dt. 21.03.2025,



Përgjigjen e KESCO-s, Transaksionet e konsumatorit, Listat e leximit dhe Rrjedhën e energjisë elektrike, Raportin mbi Kontrollimin – Pranimin e Grupit Matës me nr. 0102941 i dt. 27.03.2025, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Bordi e ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit dhe konstaton se konsumatori me njehsorin elektrik nr. 63610878 nga periudha 08/2023 e tutje ka lexime të rregullta mujore, dhe se leximi i shpenzimeve të konsumatorit behet nga distanca përmes AMR, por ka vërejtur se konsumatori për periudhat kontestuese 11/12/2024 është faturuar me vlerësim dhe kjo si rrjedhojë e mos komunikimit të njehsorit, pra konsumatori nuk është faturuar bazuar në shpenzimet reale mujore kurse në periudhën 01/2025 kemi faturim të kWh të grumbulluar. Mos faturimi i konsumatorit sipas shpenzimeve reale mujore nga KESCO është në kundërshtim me nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se: *1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar edhe për tarifën tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Bordi duke e pasur parasysh ankesën e konsumatorit për dyshim në matje të njehsorit elektrik nr. 63610878 dhe mos inspektimi i njehsorit elektrik nga KEDS, me datë 21.03.2025 ka kërkuar nga KESCO/KEDS që të behet inspektimi dhe shqyrtimi i njehsorit elektrik me pajisjen “ZERA”. Me datë 28.03.2025 KEDS ka ofruar procesverbalin nr. 0102941 të shqyrtimit të njehsorit ku është evidentuar se gabimi në matje të njehsorit elektrik është -0.21 % e që kjo vërtetohet edhe me fotografinë e ofruar nga sistemi i shqyrtimit. Bordi i ka shqyrtuar të dhënat e evidentuara në procesverbal dhe konstaton se gabimi i evidentuar i matjes për njehsorin elektrik nr. 63610878 është brenda kufijve të lejuar të gabimit të përcaktuar me Kodin e Matjes së OSSH-së e që është +/-2.5%.

Bordi duke pasur parasysh se faturimi i periudhave 11/12/2024 dhe 01/2025 nuk paraqesin shpenzime dhe faturime reale mujore të konsumatorit ka bërë shpërndarjen e kWh të faturuar për periudhën tre mujore, pra për periudhën kontestuese 11/2024 deri në periudhën 01/2025 dhe konstaton se konsumatori nuk i takon korrigjim financiar. Megjithatë, pasi gabimi në faturim është bërë nga KESCO edhe përkundër që konsumatori ka lexime të shpenzimeve përmes AMR-së, konstaton se konsumatori për faturën nr. 01250DPR-90082205 të datës 23.01.2025 duhet t’i ofrohet kontratë pagese tre mujore.

Rrjedhimisht, konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të cilën e shfrytëzojnë dhe kjo duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me energji elektrike, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si vijon: “Konsumatorët e kanë për obligim që paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”.

Bordi i pati në konsideratë edhe disa prova të tjera materiale si në shkresat e lëndës, por që të njëjtat nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast. Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar



se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti Faturave të kontestuara, të dhënave të pranuara nga KESCO si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji si dhe Rregullën për Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit I. A.,
- Arkivit të ZRrE-së